



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHETITIT

NJOFTIM

Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimet e shtetit për profesionet e rregulluara të mjekut, farmacistit, stomatologut, mamisë, fizioterapistit, logopedistit, teknikut të imazherisë dhe teknikut të laboratorit ju bëjmë me dije sa më poshtë:

- Provimet e shtetit për këto profesione të rregulluara do të zhvillohen brenda periudhës kohore nga java e tretë e muajt Dhjetor 2018 deri në javën e katërt të muajt Janar 2019.

Provimi i shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Bulevardi: "Zhan D'Ark", Nr. 23 (ish godina e ATSH), Tiranë.

Kandidati duhet të paraqitet në QSHA **30 min. para fillimit** të provimit të shtetit.

Ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me:

- letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal);
- kopje të Kartë ID ose Pasaportë;
- faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA në një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes);

Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi;
2. ndalohet duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
3. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.

Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni **emrin, atësinë, mbiemrin**, si dhe **datën dhe orën** e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën <http://www.qsha.gov.al/DPSH>, rubrika lista e kandidatëve.

Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të kontaktoni në adresën provimeshteti@outlook.com si dhe të njoftoni përpara se të hyni në ambientin e provimit.

SQARIM:

Ligji “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” në nenin 7 thekson sa më poshtë:

Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.